REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ZYRA E STREHIMIT

Nr. 281 Prot. Maliq, më 19.02.2025

PROJEKT-VENDIM

PËR

DËRGIMIN PËR BASHKËFINANCIM TË PROJEKTIT "PËRMIRËSIMI I BANESAVE EKZISTUESE PËR KOMUNITETE TË VARFËRA DHE TË PA FAVORIZUARA" PËR VITIN 2025

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit Nr. 22/2018 "Për Strehimin Social", i ndryshuar, VKM Nr. 384, datë 12.6.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", VKM Nr. 454, datë 3.7.2019 "Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese", Këshillit Bashkiak i

PROPOZOJMË:

1. Të miratojë në parim projektin "Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara" me vlerë totale 31.183.999 lekë me TVSH, me bashkëfinancim 20% Bashkia Maliq në vlerën 6.236.800 lekë dhe 80% Buxheti i Shtetit në vlerën 24.947.200 lekë, me mbështetjen e Ministrisë së Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit.
2. Të miratojë listën e familjeve përfituese nga projekti "Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara", për vitin 2025 sipas tabelës Nr.1 bashkëngjitur.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Zyra e Strehimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar.

	(Emër Mbiemër)	Nënshkrimi	Data	
Konceptoi:	I. SHKËMBI		Di. 13.02.2025	
P. Sektori:	L. MULLALLI		Di. 13.02.2025	Nr. _____Prot.
Drejtor DPKZHT:	E. JONUSLLARI		Di. 13.02.2025	

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ZYRA E STREHIMIT

Nr._____ Prot. Maliq, më 12.02.2025

RELACION MBI
PROJEKT-VENDIMIN
PËR
DËRGIMIN PËR BASHKËFINANCIM TË PROJEKTIT "PËRMIRËSIMI I BANESAVE EKZISTUESE PËR KOMUNITETE TË VARFËRA DHE TË PA FAVORIZUARA" PËR VITIN 2025

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr. 22/2018 "Për Strehimin Social", i ndryshuar VKM nr.384, datë 12.6.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", VKM Nr. 454, datë 3.7.2019 "Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese";

Ky është një projekt që zbatohet për të gjashtin vit radhazi në Bashkinë e Maliqit dhe financohet nga buxheti i shtetit me mbështetjen e Ministrisë së Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit.
Me hapjen e thirrjes së Ministrisë së Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit me shkresën Nr.15900, datë 18.12.2024 "*Mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2025*", protokolluar pranë Bashkisë Maliq me Nr. 6271 Prot., datë 26.12.2024, si dhe me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Maliq Nr. 628, datë 18.12.2024, u ngrit komisioni për verifikimin dhe hartimin e projektit për vitin 2025. Në këtë projekt janë përfshirë 39 familje të cilat kanë patur më shumë nevojë për ndërhyrje nisur nga verifikimi në terren i grupit të punës si dhe informacioni i marrë nga Njësitë Administrative nëpërmjet Vlerësimit Social Ekonomik dhe Akt Konstatimit të mbajtur prej tyre.

Duke qënë se kërkesat janë të larta Bashkia Maliq është e angazhuar të aplikojë pranë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Informacionit për këtë projekt edhe në vitet në vazhdim.

Bazuar ligjit Nr.22/2018 "Për Strehimin Social", i ndryshuar, procedura që ndiqet për këtë projekt është si më poshtë:

Neni 41
1. Objektet dhe banesat, që trajtohen nga programi i përmirësimit të kushteve, janë:
a) objektet/banesat në rrezik shembjeje;
b) objektet/banesat e amortizuara, që kanë nevojë për ndërhyrje dhe përmirësime të domosdoshme.
2. Administrimi i kërkesave dhe identifikimi i ndërhyrjeve për përmirësimin e kushteve të objekteve/banesave ekzistuese duhet të bëhet nga struktura përkatëse e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Neni 42
Instrumentet e programit të kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese
1. Programi për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese realizohet nëpërmjet grantit konkurrues për:
a) përmirësimin e kushteve të banimit e jetesës, deri në ndërtim të ri, për banesat në rrezik shembjeje;
b) përmirësimin e kushteve të banimit në banesat e amortizuara;
c) rregullimin e banesave individuale ose strukturave, të cilat nuk klasifikohen si banesë, nga vetë familjet që nuk sigurojnë të ardhurat e nevojshme për ta kryer vetë përmirësimin.
2. Kriteret dhe procedurat e përfitimit dhe dhënies së granteve konkurruese përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 43
Përfituesit nga programi i përmirësimit të kushteve të banimit
1. Nga programi i përmirësimit të kushteve të banimit, si dhe përmirësimit deri në ndërtim të ri përfitojnë familjet/individët, të cilëve u mungon një strehim i përshtatshëm.
2. Përparësi në trajtimin me këtë program kanë:
a) personat me aftësi të kufizuara;
b) individët me statusin e jetimit;
c) familjet e policëve të rënë në detyrë;
ç) të moshuarit;
d) komuniteti rom;
dh) komuniteti egjiptian;
e) komunitetet e zonave rurale;
ë) prindërit e vetëm;
f) viktima të trafikimit /viktima të mundshme të trafikimit;
g) viktima të dhunës në familje.

Referuar procesverbalit të mbajtur nga grupi i punës të ngritur sipas Urdhrit të Kryetarit Nr. 628, datë 18.12.2024, Nr. 6094 Prot., datë 18.12.2024 "Për ngritjen e grupit të punës për verifikimin në terren dhe hartimin e projektit "Për përmirësimin e kushteve të banesave të komuniteteve të varfëra dhe të pafavorizuara", ne Bashkinë Maliq", lista e përfituesve nga projekti i përmirësimit të banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pa favorizuara" për vitin 2025, është sipas Tabelës Nr. 1.

Faleminderit për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin!

	(Emër Mbiemër)	Nënshkrimi	Data	
Konceptoi:	I. SHKËMBI		Dt. 19.02.2025	
P. Sektori:	L. MULLALLI		Dt. 19.02.2025	Nr. 461 Prot.
Drejtor DPKZHT:	E. JONUSLLARI		Dt. 19.02.2025	

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim TOPÇIU

Tabela Nr. 1:

Lista e përfituesve nga projekti i përmirësimit të banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pa favorizuara" për vitin 2025:

Nr.	Emër Mbiemër (kryefamiljari)	Adresa
1	Ferdinant Sali Ibrahimllari	Fshat Maliq
2	Feridon Ramadan Lilollari	Maliq
3	Renato Sulo Takush	Maliq
4	Nebije Shefki Tefik	Maliq
5	Gurali Nazmi Sulejmani	Maliq
6	Lavderim Ahmet Ahmetllari	Kolanec
7	Aleksander Xhelal Ajrulla	Kolanec
8	Enver Fatmir Dokolli	Kolanec
9	Kujtim Etem Dokolli	Kolanec
10	Selviko Fezo Karafili	Pirg
11	Petrit Feti Kazaferi	Pirg
12	Vangjel Haxhi Demollari	Pirg
13	Spiro Nuri Markos	Pirg
14	Luljeta Shaban Hoxhaj	Pirg
15	Verije Nevruz Hasa	Pirg
16	Seit Mahmut Lami	Zemblak
17	Vasil Llazi Gaqollari	Sovjan
18	Andonaq Llazi Gaqollari	Sovjan
19	Josif Dhimitri Janllari	Sovjan
20	Muhamet Riza Hoxhalli	Sovjan
21	Stela Rakip Kasampalis	Podgorie
22	Arben Baki Bregu	Podgorie
23	Safet Ismail Laze	Podgorie
24	Bukurije Riza Guri	Podgorie
25	Sokol Engjell Topalli	Pojan

26	Mehmet Shaban Arapi	Pojan
27	Armandi Reshat Lushi	Pojan
28	Nikoleta Andrea Sarolli	Terove
29	Xhevdet Jashar Zere	Rov
30	Marsela Rafail Kote	Rembec
31	Nedime Avdyl Koro	Kloce
32	Eqrem Nesim Avdolli	Vashtemi
33	BukurijeYzeir Agolli	Vashtemi
34	Rabihan Iljas Petritaj	Strelce
35	Sokol Myzafer Salih	Vlocisht
36	Altin Vait Dume	Vlocisht
37	Osman Selim Selimllari	Orman
38	Petro Ferit Çoçka	Podgorie
39	Nekije Agush Licolli	Pojan

	(Emer Mbiemër)	Nënshkrimi	Data	
Konceptoi :	I. SHKËMBI		D/__.02.2025	
P. Sektori:	L. MULLALLI		D/__.02.2025	Nr. _____Prot.
Drejtor DPKZHT:	E. JONUSLLARI		D/__.02.2025	

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ